



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republika e Kosovës
Qyteti i Prishtinës / Prishtinë

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministry of Foreign Affairs
Ministria of Foreign Affairs

**Program Bashkëpunimi midis
Institutit për Studime Diplommatike të Ministrisë së Jashtme në
Mbretërinë e Arabisë Saudite
dhe Akademisë Diplommatike të MPJ-së së Republikës së
Kosovës**

Instituti për Studime Diplommatike i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe Akademia Diplommatike e MPJ-së së Republikës së Kosovës.

(Më poshtë referuar si "palët")

Të cilënuar nga dëshira e përbashkët për të vendosur dhe zhvilluar programin e bashkëpunimit midis tyre, (gjithashtu me dëshirën për të zhvilluar dhe forcuar më tej marrëdhëniet bilaterale dhe të miqësisë):

Janë pajtuar si vijon:

Neni 1

Qëllimet e Programit të Bashkëpunimit:

- Për të vendosur dhe forcuar bashkëpunimin në fushën e informacionit, aktiviteteve kërkimore, dhe programeve trajnuese, që kanë të bëjnë me Diplomacinë, të Drejtën Ndërkombëtare dhe Politikën, si dhe shkëmbimin e dokumenteve, studimeve dhe informacionit.
- Bashkëpunimi midis dy palëve nuk drejtohet nga konsideratat komerciale.

Neni 2

Fusha e Programit të bashkëpunimit:

- Palët njohin nevojën e zhvillimit dhe përdorimit të metodave moderne në fushën e trajnimit të protokollit diplomatik dhe dëshmive konsullorë në: politikën e jashtme, marrëdhëniet ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare, ekonominë ndërkombëtare, shkencat politike dhe subjekte të tjera përkatëse.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministarstvo Inostranih Poslova
Ministry of Foreign Affairs

- B) Palët pajtohen të bashkëpunojnë në fushat e lidhura me metodat e mësimit dhe kërkimit, dhe për konsultimin e ndërsjellë në çështjet e lidhura me mësimin e gjuhëve të huaja.
- C) Palët pajtohen të krijojnë programe të përbashkëta për trajnime bazike dhe të specializuara për diplomatët me qëllim të përmirësimit të shkathtësive të tyre diplomatike.
- D) Palët pajtohen të informojnë njëra-tjetrën në çështjet e lidhura me teknikat e mësimit dhe kërkimit shkencor, dhe shkëmbimin e publikimeve dhe ekspertizës.
- E) Palët pajtohen të shkëmbejnë vizitat e specialistëve për workshope, simpoziume dhe konferenca.
- F) Palët pajtohen të shkëmbejnë ekspertizën në fushat e lidhura me organizimin e librave, edukimit dhe administrimin e institucioneve edukative.
- G) Palët pajtohen të shkëmbejnë pedagogët dhe studentët me qëllim të promovimit të shkathtësive të tyre profesionale.
- H) Palët pajtohen të mbajnë takime dhe diskutime të rregullta për çështje me interes të përbashkët me pjesëmarrjen e zyrtarëve të Ministrive respektive të Punëve të Jashtme, përfaqësuesve të misioneve diplomatike, si dhe anëtarëve të tjerë të fakultetit, dhe studentëve.
- I) Palët pajtohen të ofrojnë sipas kërkesës kurse speciale gjuhësore në gjuhët arabe, angleze dhe shqipe.

Neni 3

Aspekti financiar i Programit të Bashkëpunimit:

Të dy palët pajtohen se kostoja që është rezultat i implementimit të ndonjërit prej neneve të këtij programi, duhet të mbulohet nga pala përgjegjëse.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministarstvo Inostranih Poslova
Ministry of Foreign Affairs

Neni 4

Zbatimi i Programit të Bashkëpunimit:

- A) Ky Program Bashkëpunimi duhet të implementohet në pajtim me ligjet dhe rregulloret e të dy palëve nënshkruese të këtij programi.
- B) Programi do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga të dy palët për një periudhë trevjeçare dhe automatikisht do të zgjatet për një periudhë pasuese prej një viti, vetëm nëse njëra nga palët informon tjetrën, në formë të shkruar, për synimin e saj për t'i dhënë fund programit jo më vonë se tre muaj para datës së përfundimit të tij.

Nënshkruar në Riad më 08 / 04 / 2012, në dy kopje origjinale: secila prej tyre në arabisht, shqip dhe anglisht me të gjitha tekstet autentike. Në rast të ndonjë divergjence në interpretimin e ndonjërit prej neneve të këtij program, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

Prof. Abdulkarim H. Al Dekhayel
Për
Institutin e Studimeve Diplomatike
Ministria e Punëve të Jashtme
Mbretëria e Arabisë Saudite

Prof. Dr. Ibrahim Gashi, Zëvendës Ministër
për Punë të Jashtme i Republikës së Kosovës
Për Akademin Diplomatike
Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës
së Kosovës